



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.977/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Afijete Sada Glllogjani kryesuese Zyhdi Haziri dhe Kimete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Teuta Haxhiu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Glllogocit, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.977/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Teuta Haxhiu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Glllogocit, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimet VV 0301E/01R, VV 03016/02R, 0301E/03R, 0301E/04R, 0301E/05D, 0301X/01R, 0301X/02R, 0301X/03X, 0301X/04D, 0315E/01R, 0315E/02D, në komunën e Glllogocit.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.977/2021 të paraqitur nga Teuta Haxhiu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik LDK me të cilën pretendon se në vendvotimet VV 0301E/01R, VV 03016/02R, 0301E/03R, 0301E/04R, 0301E/05D, 0301X/01R, 0301X/02R, 0301X/03X, 0301X/04D, 0315E/01R, 0315E/02D, në komunën e Glllogocit ka pasur keqpërdorim të votave nga kryesuesit dhe komisionerët e këtyre vendvotimeve. Në mbështetje të pretendimeve të saj e njëjta nuk ka paraqitur asnjë dëshmi si provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:


Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Teuta Haxhiu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Glllogocit, me të cilën kërkon rinumërim të votave në Vendvotimet VV 0301E/01R, VV 03016/02R, 0301E/03R, 0301E/04R, 0301E/05D, 0301X/01R, 0301X/02R, 0301X/03X, 0301X/04D, 0315E/01R, 0315E/02D, në komunën e Glllogocit është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apelueses nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.977/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.